



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0124

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së OE “AOME” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritenderim- Furnizim me dru per shkolla dhe institucione tjera qe funksionojne ne kuader te Komunës se Ferizajt” me numër të prokurimit 656-24-10267-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA FERIZAJ”, më 10/04/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjeserisht e bazuar ankesa e “AOME” SH.P.K. me nr. 2025/0124, e datës 18/02/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ritenderim- Furnizim me dru per shkolla dhe institucione tjera qe funksionojne ne kuader te Komunes se Ferizajt”, me numër të prokurimit 656-24-10267-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KOMUNA FERIZAJ”.

2. Mbetet në fuqi B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA FERIZAJ” për aktivitetin e prokurimit “Ritenderim- Furnizim me dru per shkolla dhe institucione tjera qe funksionojne ne kuader te Komunes se Ferizajt”, me numër të prokurimit 656-24-10267-1-1-1.

3. Detyrohet Autoriteti Kontraktues për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

4. Lejohet kthimi i tarifave të ankesë në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 30.09.2024, "KOMUNA FERIZAJ" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ritenderim- Furnizim me dru per shkolla dhe institucione tjera qe funksionojne ne kuader te Komunës se Ferizajt" me numër të prokurimit 656-24-10267-1-1-1, ndërsa Vendimi i Autoriteti Kontraktues është ngritur me datën 03.02.2025 për dhënie të kontratës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur të hapur, furnizim vlere e parashikuar e kontratës: 350,000.00€.

Me 06.02.2025, OE "AOME" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 10.02.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18/02/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga "AOME" SH.P.K., me nr. 2025/0124 lidhur me aktivitetin "Ritenderim- Furnizim me dru per shkolla dhe institucione tjera qe funksionojne ne kuader te Komunës se Ferizajt" me numër të prokurimit 656-24-10267-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: "Pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana juaj, ne si Autoritet Kontraktues konsiderojmë se pikat ankimore të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim janë të pabazuara. Operatori Ekonomik AOME SHPK i pa kënaqur ndaj njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit Ritenderim- Furnizim me dru per shkolla dhe institucione tjera qe funksionojne në kuader te Komunes se Ferizajt, me Numër të prokurimit 656-24-10267-1-1-1 duke supozuar se është shkelur disa dispozita të LPP-së. Autoriteti Kontraktues brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku konstaton si në vijim: Ne si Autoritet Kontraktues konsiderojme se nuk kemi bere asnje shkelje te LPP-se dhe asnje shkelje te vendimit te OSHP-se pasi qe ne perpikmeri ne kemi respektuar ate vendim ku lenda është kthyer në rivegesim dhe në të njëjten kohë ne ju kemi drejtuar edhe Agjensionit Pyjor te Kosoves për sqarim siç na është kërkuar nga ana e Panelit te OSHP-se. Në përgjigje e tyre ata na kane sqaruar se nje dokument i till të cilen e ka prezentuar Operatori i perzgjedhur nga ana e AK eshte valid pasi qe Agjensioni Pyjor i Kosoves ka filluar ta leshoje kete dokument pas prillit te vitit 2023 ndersa nga ky OE thuhet qe koto dru jane blere ne vitin 2020 dhe 2022 dhe si dokument I tille mirret si i mireqent duke marre parasysh qe te njejtin e ka deshmuar edhe përgjigja e Drejtorit te Drejtorise per Bujqesi ne Ferizaj gjithashtu edhe ne Dosie te Tenderit nga ana e AK eshte lene opsioni qe keto deshmi te ofrohen nga Komuna ose Agjensioni Pyjor i Kosoves."

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “AOME” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

“Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë. 25.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. “Të arsyeshme dhe të mjaftueshme” do të nënkuptoj në lidhje me: Në këtë përshkrim të shkeljeve të konstatuara më tepër do të përqendrohemi në shkeljet të cilat kanë ndodhur lidhur me Nenin 59 Është shkelur neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, si dhe nenin 40 të RPP Në njoftimin për kontratë të publikuar në web faqen e platformës elektronike të KRPP-së të autoritetit kontraktues Komuna e e Ferizajt Republika e Kosovës; dhe në dokumentet të cilat përbëjnë dosjen e tenderit: Ju në B58 -Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues Dhënie e kontratës publike Letër Standarde për tenderuesin kandidatin e pasuksesshëm e datës 03/02/2025 Në pajtim të plotë me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores nr. 001/2024 për Prokurimit Publik, nenin 32 paragrafi 32.4 prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues nuk mundë të ndryshoi asnjë aspekt të një tenderi ndërsa, Tenderuesi është përgjegjës për ti ngarkuar të gjitha dokumentet e kërkuara në sistemin elektronik të prokurimit të Kosovës para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve si dhe për të siguruar saktësinë e tenderëve të tyre, bazuar në kërkesat e parashtruara në dokumentin Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD). Në këtë mënyrë Ju si autoritet kontraktues nuk keni respektuar këto kërkesa dhe për pasojë keni bërë devijim thelbësorë nga kërkesat e përcaktuara dhe specifikimet e detyrueshme teknike, gjegjësisht keni bërë devijim qenësor - thelbësorë nga kërkesat e tenderit, gjë që ka bërë që vlerësimi për rregullshmërinë e dëshmive të dorëzuara lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale të mos jetë i plotë, i rregullt dhe i pranueshëm. Andaj, në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullave për prokurimin publik në Kosovë, oferta e jonë është trajtuar si ofertë e pasuksesshme nga komisioni për vlerësimin e ofertave. **Provë:** AK - KOMUNA E FERIZAJT, me datë 03/02/2025, përmes platformës elektronike e- prokurim na njofton për marrjen e vendimit - Njoftimi mbi vendimin e AK, që do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore të LPP- se, dhe rreg. Nr. 001/2024 për PP të cilën do i argumentoj dhe dëshmojnë me prova dhe fakte konkrete si ne vazhdim të kësaj ankese. Paragrafi 11 nenit 7 të LPP -se e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojnë në mënyrë transparente” , ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos e propozuar që oferta e jonë të shpërblehet me kontratë për aktivitetin e lartcekur të prokurimit.Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 1 të LLP-se pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe më të ,drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktues në Republikën e Kosovës, pasi që ne si pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit jemi tenderues i përgjegjshëm me çmimin më të ulët, oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës është ofertë e papërgjegjshme.Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshrni mbi prejardhjen e druve nga (Drejtoria Komunale për Bujqësi dhe Pylltari ose Agjencioni i Pyjeve të Kosovësje nënshkruar dhe u vulosur.- (originale apo kopje e vërtetuar në Komune ose tek Noteri) Autoritetit kontraktues komuna e Ferizajt - Zyra e Prokurimit keni pranuar një DËSHMI të lëshuar me datë 20/08/2024 nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë e komunës tuaj që nuk është kompetente dhe e autorizuar për lëshimin e dëshmive, përkatësisht vërtetimeve të tilla. Vërtetimin përkatës të cilin ju e keni kërkuar është e autorizuar

të lëshojë vetëm Agjencia Pyjore e Kosovës -APK. Ketë e vërtetojnë nenet përkatëse të: Në nenin 53 të Ligjit NR. 08/L-137 PËR PYJET Neni 53 Mënyrat kontraktuese të shfrytëzimit të pyjeve shtetërore Paragrafi 1 i këtij neni thotë:1. “Përgjegjësia dhe detyrat për sigurimin e shfrytëzimit të pyjeve shtetërore realizohen nga Agjencia në përputhje me këtë ligj”. KAPITULLIXIII DISPOZITAT KALIMTARE.Neni 76 Zbatimi Paragrafi 3 i këtij neni thotë:3. “Të gjitha të drejtat, detyrimet, asetet, pronat e luajtshme, të paluajtshme, kërkesat pronësore, dhe çfarëdo pretendimi tjetër i lidhur me Ekonomitë Pyjore, të përcaktuara sipas nenit 3, nen paragrafi 1.11 të këtij ligji dhe me Ekonomitë e Gjuetisë, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji kalojnë në kompetencat administrative të Agjencisë” Ky ligj është shpallur me dekretin Nr, DL-58/2023, datë 24/03/2023.Që donë të thotë se nga data e hyrjes në fuqi të gjitha kompetencat dhe përgjegjësit kanë kaluar në Agjencia Pyjore e Kosovës - APK.* Është shkelur Vendimi i Panelit Shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit, OSHP: 2024/1147, përkatësisht nuk ka zbatuar, nuk ka përfillur Vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së OSHP: 2024/1147 në të cilin Vendim në mënyrë detale është trajtuar ankesa jonë dhe ka prurë këtë:Vendim 7. “Aprovohet, e bazuar ankesa e “AOME” SH. P.K. me nr. 2024/1147, e datës 25/11/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit- Furnizim me dru për shkollë dhe institucione tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt me numër të prokurimit: 656-24-10267-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Ferizajt, ndërsa Vendimi i datës 05/11/2024 kthehet në rivlerësim”.Autoriteti kontraktues Komuna e Ferizajt sipas kërkesës së panelit shqyrtues të OSHP- së ka kërkuar sqarime nga Agjencia Pyjore e Kosovës -APK. Me datë 23/01/2025. Formulimi i pyetjes në këtë kërkesë për sqarime nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Ferizajt nuk është bërë si duhet “i nderuar z. Dema, kërkojmë nga ana e juaj që të na njoftoni nëse ky dokument i lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë konsiderohet valid nga ana e juaj”.Përgjigja e zyrtarit përgjegjës të Agjencisë Pyjore të Kosovës -APK. “Prandaj dokumenti i lëshuar Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë e komunës përkatëse mbetet në domenin e autoritetit kontraktues që të bëjë vlerësimin, duke pasur parasysh edhe procedurat e shitjes së masës drusore janë zhvilluar nën autoritetin përkatës komunal”.Por në paragrafin tjetër të kësaj përgjigje sqaron: “Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit me nr. 08/L-137 për Pyje në prill të vitit 2023 kompetencat e mbrojtjes se pyjeve dhe dhënia e lejeve për prerje (procedura e shitjes) ishte e komunave dhe si e tillë edhe në kuptimin e dokumenteve edhe në procedurë autoriteti vetëm kanë qenë komunat”.Nga ky sqarim shihet shumë kjashtë se nga data e ndryshimit të Ligjit me nr. 08/L-137 për Pyje në prill të vitit 2023 të gjitha kompetenca dhe përgjegjësit kanë kaluar të Agjencia Pyjore Kosovës-APK.Prandaj ne konsiderojmë se vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë e komunës se Ferizajt nuk e përmbush kriterin e kërkuar nga autoriteti kontraktues komuna e Ferizajt - Zyra e Prokurimit.Prandaj ftojme autoritetin kontraktues Komuna e Ferizajt - zyra e prokurimit që të bëjë vlerësimin real dhe ligjor të ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës. Si dhe kërkojmë nga AK që të ndërmerr masa për të mënjeluar shkeljet e konstatuara ligjore, në mënyrë që aktiviteti i prokurimit të jetë i vlerësuar dhe i vendosur konform LPP për të siguruar zbatim të drejtë të dispozitave të LPP-së që të arrihet parimi i prokurimit “Vlera për Paranë”, sepse oferta jonë është e përgjegjshme ashtu siç edhe komisioni vlerësues e ka trajtuar.Çdo justifikim i mundshëm në cilësinë e Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit nuk mund të mbështet me asnjë normë ligjore dhe as etike - profesionale, këtë duhet të këtë parasysh ngase është duke ushtruar një funksion publik që iu është besuar të ushtroi profesionin, të kryej detyrat me kompetencë dhe përgjegjësi, ndershmëri, besnikëri dhe në pajtim me ligjin.Zyrtarit Përgjegjës i Prokurimit i autoritetit kontraktues komuna e Ferizajt Republika e Kosovës duhet të jetë i vetëdijshëm se mund të këtë pasoja deri të marrja e përkohshme e certifikatës themelore apo të avancuar të profesionalizmit në prokurim si dhe të gjëbjetet autoriteti kontraktues Komuna Ferizajt Republika e Kosovës me

një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare, (por si duket janë mësuar me paguar gjoba me mjetet tona - taksa paguesve dhe për këtë nuk mërzhiten fare pasi askush nuk përgjigjet për këto shpenzime të pa arsyeshme).Kështu që vetëm sa do të zgjatet realizimi i këtij aktivitetit të prokurimit, në tërësi me fajet e juaja.Kësaj Ankese për vëmendjen tuajpo ia bashkëngjisim edhe këto dokumente me rëndësi: -Kopjen e vendimitme numër tëprotokollitKA nr.560/24 tëlëshuar nga GJKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative. Me të cilin vendim anulohet vendimi me nr. PSH: 828/24 i datës 25/10/2024.-Kopjen e Kërkesës me numër të protokollit 110/25 të datës 03/02/2025 dërguar Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) për njoftim. Emailët të cilat autoriteti kontraktues komuna e Ferizajt i ka këmbye me Agjencia Pyjore Kosovës -APK.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Shkeljet e dispozitave ligjore nga Autoriteti kontraktues Komuna Ferizajt Republika e Kosovës janë ; Është shkelur neni 1 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Qëllimi,) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92 Është shkelur neni 6 i Ligjit të Prokurimit PublikNr. 04/L-042 (ekonomiciteti dhe efikasiteti i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, Është shkelur neni 7 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Barazia në trajtim Jo- Diskriminimi) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjinNr.05/L-92, Është shkelur neni 28 i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 (Specifikimet teknike) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, Është shkelur neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92 Është shkelur neni 40 i RRPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve). Është shkelur neni 51 (Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237,ligjin Nr.05/L-068 dhe igjin Nr.05/L-92, Është shkelur neni 25.9 i Rregullores Nr. 001/22 për prokurim publik (Kriteret e përzgjedhjes) Është shkelur neni 53 i Ligjit Nr.008/L-137 PËR PYJET Është shkelur neni 76 i Ligjit Nr.008/L-137 PËR PYJET Është shkelur neni 9.1 &9.2 i Dosjes së tenderit si dhe III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional i Njoftimit për kontratë ; Është shkelur Vendimi i Panelit Shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit, OSHP: 2024/1147 idatës 21/01/2021 Në nenin 25 të 25 i Rregullores Nr.001/2024 Për Prokurimin Publik. Në bazë të të gjitha atyre që u shtjelluan më lartë kërkojmë nga Eksperti shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) që të pajisë Panelin Shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me një raport real dhe të mirëfilltë që ka të bëjë me këtë lëndë dhe krejt në fund Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), pas shtjellitimit të provave, dëshmimeve dhe fakteve të paraqitura në këtë Ankese të bie: VENDIM te -MIRATOHET e bazuar Ankesa e operatorit ekonomik AOME SH.P.K. -ANULOHEM Vendimi, përkatësisht Njoftimi për Dhënie të Kontratës i publikuar ueb faqen e platformës elektronike të KRPP-së me datë 03/02/2025 -ANULOHEM Vendimi Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm i operatorit ekonomik AOME SH.P.K. Lagja Kolovicë, Gjeravica. 10000 Prishtinë si dhe Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhënie e kontratës, të merren masa adekuate (për eliminimin e lëshimeve ligjore dhe të vendoset që aktiviteti i lartcekur i prokurimit – lënda të kthehet në ri-vlerësim pas ri-vlerësimit nga ana e autoritetit kontraktues të shpërblehet me kontratë oferta e operatorit ekonomik AOME SH.P.K. Lagja Kolovicë, Gjeravica. 10000 Prishtinë si ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët që i ka plotësuar të gjitha kriteret e specifikuara në Njoftimin për Kontratë dhe në dokumentet të cilat e përbëjnë dosjen e tenderit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 20.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar

të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0124/25, ndërsa me datë 03.03.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0124 me rekomandimet si në vijim: *Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.*

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “AOME” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0124 ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se operatori ekonomik ankues i pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues / Komuna e Ferizajit, ka parashtruar ankese në OSHP, me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar vendimin e Panelit shqyrtues me nr: 1147/2024 dhe njëherit pretendon se AK-ja, e ka marrë parasysh vërtetimin e OE të rekomanduar për kontrate të leshuar nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë.

Eksperti shqyrtues, sqaron se Autoriteti Kontraktues, pas pranimi të vendimit me nr: 1147/2024, e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me dru për shkollë dhe institucione tjera që funksionojnë në kuader të Komunes së Ferizajt dhe sipas udhëzimeve të dhëna në vendimin 1147/24, ka kërkuar sqarim nga Agjensioni Pyjor i Kosovës, lidhur me kompencën / autorizimet se cila zyre ka të drejtë ligjore për t'i lëshuar këto vërtetime

Agjensia Pyjor e Kosovës, ka deklaruar: *"Duke pas parasysh interpretimin e organit kompetent, autoriteti kontraktues ka vendosur ta pranojë dokumentin në fjalë, për arsye se, nga muaji Prilli i vitit 2023 kjo kompetencë ka kaluar tek Agjensioni Pyjor i Kosovës, ndërsa sipas dëshmi të ofruara nga OE i rekomanduar për kontrate, masa drusore e siguruar nga i rekomanduari për kontrate është nga viti 2021-2023 nga shitjet që ka bërë Komuna e Ferizajit dhe njëherit kjo ceshtje sipas interpretimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës, është lënë në kompetencë të autoritetit kontraktues që të bëjë vlerësimin, duke pas parasysh që procedurat e shitjes së masës drusore janë zhvilluar nën autoritetin e Komunes së Ferizajit."*

Eksperti shqyrtues, poashtu sqaron se lidhur me këtë ceshtje, eksperti shqyrtues, ka dhënë sqarimet e veta në raportin e ekspertizës me nr. 1147/2024 të datës 09.12.2024.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohej nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit,

përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të Autoritetit Kontraktues – “KOMUNA FERIZAJ” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ritenderim-Furnizim me dru për shkollë dhe institucione tjera që funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt”, me nr. të prokurimit: 656-24-10267-1-1-1.

Me qëllim që vendimi i panelit të jetë konform nenit 31 paragrafi 4 dhe paragrafi 6 të Rregullores së Punes së OSHP-së ankesa kualifikohet si pjesërisht e bazuar në mënyrë që të lejohet kthimi i mjeteve me rastin e paraqitjes së ankesës, andaj ankesa kualifikohet si pjesërisht e bazuar për faktin se kjo lëndë është trajtuar edhe me një vendim paraprak dhe për të cilin janë trajtuar pretendimet e njëjta ankimore.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA FERIZAJ**
- **OE - " AOME " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: